



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 447 Prot.

Tiranë, më 28.03 2019

VENDIM Nr. 73 datë 18.03.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, datë 18.03.2019, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Antigonea" 2019*, drejtuar nga Prof.Dr. Dhimitër Çondi, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Antigonea" 2019*, drejtuar nga Prof.Dr. Dhimitër Çondi, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Sondazhe në Akropolin e qytetit;
 - Sondazhe në Teatër;
 - Pastrimi i një tempulli ekstra urban jashtë sistemit fortifikues të qytetit.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al